



Njoftim për tatimpagues

“I punësuari mund të aplikoj për subvencionim të pagës”

Bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 13/19, datë 14.07.2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, si dhe Vendimet e Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, gjegjësisht Vendimet për subvencionim sipas masave: 1.1 – Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë; 1.2 - Mbështetja për të punësuarit e formalizuar, si dhe 1.3 - Mbështetja e punësimit të grave, **Administrata Tatimore e Kosovës, ka zhvilluar aplikacionin dhe tashmë të punësuarit mund të parashtrojnë kërkesat e tyre për të përfituar nga këto masa.**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të punësuarit e rinj, të cilët janë të deklaruar në Administratën Tatimore të Kosovës për periudhat nga Korrik/2021 e tutje.

Aplikimi bëhet përmes Aplikacionit të publikuar në ueb-faqe të ATK-së www.atk-ks.org.

Pra, përmes ueb-faqes së ATK-së, të punësuarit kanë mundësi të aplikojnë për të përfituar nga masat e Pakos së e Ringjalljes Ekonomike, si:

- Masa 1.1 – Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë - Mbështetje për tre (3) muaj nga njëqind euro (100€);
- Masa 1.2 – Mbështetja për të punësuarit e formalizuar - Mbështetje për tre (3) muaj nga pesëdhjetë euro (50€);
- Masa 1.3 – Mbështetja e punësimit të grave - Mbështetje për tre (3) muaj nga pesëdhjetë euro (50€);

Aplikimi është i hapur nga sot dhe deri më **15 tetor 2021** në ora **24:00**.

Aplikacioni “Pako e Ringjalljes Ekonomike – Kërkesë për subvencionim të pagës” është në dispozicion të tatimpaguesve, gjegjësisht të punësuarve në ueb-faqen e ATK-së www.atk-ks.org - tek linku [Shërbimet elektronike](#).

ATK, çdo herë e gatshme në ofrimin e shërbimit për tatimpagues!

Administrata Tatimore e Kosovës